

SYLLABUSI I LËNDËS TEORIA E TREGJEVE FINANCIARE

Të dhënat Bazike për lëndën	
Njësia Akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Teoria e Tregjeve Financiare
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimit:	Viti i dytë
Numri i orëve për javë:	2 + 0
ECTS kreditë:	4
Koha/Lokacioni:	Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
Mësimdhënësi i lëndës:	Valentin Toci
Detajet kontaktuese të mësimdhënësit:	valentin.toci@uni-pr.edu
Përmbajtja e Lëndës:	Kjo lëndë zgjerohet mbi lëndën e hyrjeve në financa për t'i prezantuar studentët me mjedisin e tregjeve financiare në të cilat veprojnë bizneset. Studentët hulumtojnë natyrën dhe rolin e tregjeve kryesore financiare brenda mjedisit lokal dhe global. Lënda paraqet një pasqyrë të sistemit financiar dhe tregjeve, instrumenteve dhe institucioneve të ndryshme financiare. Studentët do të shfrytëzojnë të dhëna reale për të hulumtuar aplikacionet e përbashkëta të tregut financiar.
Qëllimet e Lëndës:	Qëllimi i kësaj lënde është që të ofrojë studentëve njohuri në fushën e tregjeve financiare, të instrumente specifike të tregut financiar, njohuri për që t'u mundësojë atyre të kuptojnë proceset e tregjeve financiare dhe faktorët e tyre dhe të marrin vendime financiare me sukses mbi individin si dhe në nivel të kompanisë. Gjithashtu ky kurs është i dizajnuar për t'i pajisur studentët me njohuri për sistemit financiar dhe kornizën e tij rregullative dhe mjediseve në Kosovë dhe se si paraqitet në ekonomitë e zhvilluara.
Rezultatet e pritura të mësimnxënies:	Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje: Të kuptojë rolin e sistemit financiar në ekonomi. Të demonstrojnë njohuri për shumëllojshmërinë e instrumenteve financiare. Të përshkruajnë hipotezat efikase të tregut.

	Të jenë në gjendje të shpjegojnë pse ekzistojnë ndërmjetësuesit financiarë dhe çfarë është roli i institucioneve financiare në ekonominë moderne. Të demonstrojnë rëndësinë e rrezikshmërisë dhe strukturën e normave të interesit. Të jenë në gjendje ta kuptojnë se si përcaktohet vlera afatshkurtër dhe afatgjatë e monedhës. Të kenë njohuri mbi historikun e sistemit të kursit të këmbimit dhe të ndërhyrjes së bankës qendrore në tregun e parasë, në tregjet financiare të kontrolluara dhe të pakontrolluar. Të jenë në gjendje të shpjegojnë dallimet midis marrëveshjeve, opsioneve dhe këmbimeve.		
Ngarkesa e punës së studentëve (orë në semestër, ECTS)			
Aktiviteti	Javë	Orë	Totali
Ligjërata	2	15	30
Seminare (Teori dhe Praktikë)			
Raste Studimore			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në Teren			
Kollekfiume (Teste)	2	15	30
Detyra të Shtëpisë			
Studimit vetanake të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja për provimin final	1	10	10
Vlerësimi			
Projektet, prezantimet etj.			
Totali			100
Metodologjia e Mësimdhënies:	Shpjegimet teorike dhe shembujt praktikë përdoren gjatë gjithë ligjëratave, dhe synojnë të ofrojnë njohuri të avancuara për t'i përmirësuar aftësitë financiare. Metoda e mësimdhënies është interaktive dhe u mundëson studentëve që të bëjnë pyetje rreth problemeve aktuale brenda ligjëratave të mbajtura.		
Metodat e Vlerësimit:	Vlerësimi i studentëve përbëhet nga: Monitorimi i punës së studentëve gjatë ligjëratave dhe pjesëmarrja e tyre aktive në grupe punuese dhe përgatitja e seminareve.		

Literatura:	
Literatura bazë:	1. Financial Markets and Institutions (8th Edition) (Pearson Series in Finance) Frederic S Mishkin, Stanley Eakins, January 12, 2014, 2. Financial Markets and Institutions (The McGraw-Hill/Irwin Series in Finance, Insurance and Real Estate) [Hardcover], Anthony Saunders , Marcia Millon Cornett, September 19, 2011, 3. Financial Markets and Institutions ([Hardcover], Jeff Madura, January 1, 2014,
Literatura shtesë:	4. Introduction to the Economics and mathematics of financial markets Fernando Zapatero, Jaksa Cvitanic 2004.

Plani i detajuar i punës:	
Java	Temat
Java 1	Pse të studiojnë tregjet dhe institucionet financiare.
Java 2	Vështrim i përgjithshëm mbi sistemit financiar
Java 3	Çfarë kuptojmë me normat e interesit dhe cili është roli i tyre në vlerësim?
Java 4	A janë tregjet financiare efikase?
Java 5	Pse ekzistojnë institucionet financiare?
Java 6	Testi i parë
Java 7	Pse ekzistojnë institucionet financiare?
Java 8	Pse ndodhin kriza financiare dhe pse ato janë aq të dëmshme për ekonominë?
Java 9	Bankat dhe Menaxhimi i Institucioneve Financiare
Java 10	Rregullimet Financiare
Java 11	Zhvillimi i Politikës Monetare: Mjetet, Qëllimet, Strategjia dhe Taktikat
Java 12	Tregu Financiar
Java 13	Menaxhimi i Rrezikut në Institucionet Financiare
Java 14	Mbrojtja nëpërmjet Derivateve Financiare
Java 15	Testi i dytë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Pjesëmarrja e rregullt në ligjërata dhe ushtrime është e detyrueshme për të gjithë studentët. Të gjithë studentët janë të detyruar të ndjekin rregullat e etikës: mbajtjen e paqes, shkyçjen e telefonave celularë dhe hyrjen me kohë në klasë.